



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE**

**PROCESVERBAL PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E**  
**PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT**  
**“BLERJE MATERIALE BOJAXHIU”**

I mbajtur sot në datë 08.05.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje materiale bojaxhiu”**, me fondin limit **33 963 055** (*tridhjetë e tre milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëdhjetë e pesë*) **Lekë pa Tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (*i ndryshuar*) parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*  
*2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsye të mëposhtme:

**Së pari**, do të ishte shumë më efikase që kjo kontratë të realizohej nga një operator ekonomik pasi do të organizohej një rend i saktë i shpërndarjes së mallrave në kohë dhe sasi. Për këtë shkak të parashtruar më sipër marrëveshja kuadër duhet të lidhet me një operator ekonomik. Si përfundim, me qëllim garantimin e furnizimit në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

**Së dyti**, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me llojin e mallrave, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të

prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

**Së treti,** Lloji i mallrave objekt prokurimi është ngushtësisht i lidhur me natyrën e punimeve për të cilat do të përdoren. Përgjithësisht, nga natyra e punëve që mbulon autoriteti kontraktor sipas fushës së veprimtarisë do të përdoren mallra të ndryshme për kryerjen e së njëjtës punë dhe duhet patjetër që këto mallra të përkojnë me standartet teknike të njëra-tjetrës pasi në DST specifikimet teknike janë përcaktuar me diapazon brenda limiteve maksimale dhe minimale ose ekuivalente (sipas përcaktimeve ligjore dhe rekomandimeve të APP) dhe mundësia që ato nuk janë të njëjta nga ofertues të ndryshëm është shumë e madhe psh. nuk mund të përkojnë mënyra e montimit të zgjatuesve me furçat dhe rulat etj. Element tjetër është mundësia e reaksionit kimik të produkteve që do të përdoren për të njëjtën punë psh. boja me astarin, llaku me astarin etj. Për këto shkaqe të parashtruara më sipër marrëveshja kuadër duhet të lidhet me një operator ekonomik.